



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:029155

Datë: 02.07.2019

Numri i dokumentit: 00387162

P nr.849/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Elmaz Zenuni dhe me sekretaren juridike Igballe Arifi, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.K nga Shtimja, Rrugapa nr., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II Nr.1105-5/2018 të datës 18.06.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 01.07.2019, në praninë e Prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit dhe dëshmitarës, mori dhe publikisht shpalli , ndërkaq, me dt. 02.07.2019, me shkrim përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, E.K nga Shtimja, Rrugapa nr., i lindur me, në, nga i ati M.... dhe ëma Q.... e gjinisë Xh....., i martuar baba i 4 (katër) fëmijëve, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së verfër ekonomike, me nr.personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 01.05.2018 rreth orës 08:20 në Rrugënnë Shtime, me dashje ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarës-ish bashkëshortes së tij A.Sh, në atë mënyrë që pas një fjalosj verbale e sulmon filikisht dhe e kap për fyti të dëmtuarën,-

me të cilën ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim të nenit 184 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 4, 7, 41, 46, 49, 50, 51,52 dhe 73 të KPRK-së , si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

DENIM ME KUSHT

I VËRTETOHET DENIMI me burg në kohëzgjatje prej 4(katër) muajve, i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së katgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 30 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara A.S.Sh nga fshatinë emër të kërkesë pasuror-juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsy etimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ushtruar aktakuzë me akuzën e vet Ferizaj Ferizaj PP/II Nr.1105-5/2018 të datës 18.06.2018, kundër të akuzuarit E.K nga Shtimja, Rrugapa nr., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas akuzës së PTH-së në Ferizaj më datën 13.08.2018 ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 27.05.2019, ndërkaq me datën 01.07.2019 ka mbajtur shqyrtimin kryesor gjyqësor, në të cilën Prokurori i shtetit Valdet Avdiu, si në fjalën hyrëse, por edhe ate përfundimtare deklaroi: se ngel në tërësi pranë akuzës për veprën penale dhe kualifikimit juridik të veprës penale. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, konform nenit 350 të KPPRK-së, prokurori i shtetit ka ndyshuar aktakuzën sa i përket kualifikimit juridik të veprës penale, ku ka kualifikuar veprën penale të njet sulmi nga paragrafi 3 i nenit 187 të KPRK-së në *paragrafin 1 të nenit 184 të KPRK-së (Kodi i ri Penal, i cili është më' i favorshëm për të pandehurin)* dhe i ka propozuar gjykatës që të nxjerrë provat e propozuara në akuzë, dhe pas vlersimit të tyre i akzuari të shpallet fajtor dhe të i shqitpohet dënimi i paraparë me ligj.

I akzuari E.K në shqyrtimin fillestar, por edhe në shqyrtimin gjyqësor delaroi: se nuk e ndin vehtë fajtor për veprën penale e cila i vëhet në barrë, pra për veprën penale sulmi nga neni 184 par.1 i KPRK-së dhe shton se: unë është e vërtetë se kam pasur fjalosje me ish bashkëshorten time A.Sh me të cën nuk kam pasur kurorë.Ditën kritike, është e vërtetë se kam pasur sulmue verbalisht, por nuk e kam kapur për fyti.

Gjykata pasi që ka dëgjuar fjalën hyrëse të prokurorit të shtetit i cili në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se do të vërtetohen faktet e veprës penale të sulmi për të pandehurin E.K, ku e dëmtuar është A.Sh, e kjo do të vërtetohet në bazë të

dëshmisë së dëshmitarës së dëmtuar A.Sh dhe vetë deklaratës së të akuzuarit, të cilat deklarata janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Gjykata bëri zbatimin e provave dëgjoj dëshmitaren-të dëmtuaren A.Sh, e cila në shqyrtim gjyqësor deklaroi se : rastin e kam lajmëruar në polici dhe të njejtën deklaratë e mbroj edhe tani. Ditën kritike vijon dëshminë e saj dëshmitarja e dëmtuara më ka sulmuar ish bashkëshorti im E.... duke më sulmuar pos verbalisht, por edhe fizikisht duke më kapur për fyti.Unë vijon dëshminë e saj dëshmitarja kam pasur probleme edhe më herët me E...., por ato i kam tejkalëuar, kurse tani me vajzën time të cilën e kam me ish bashkëshortin tim me të cilin nuk kam pasur kurorë nuk jetoj me te dhe së bashku me vajzën time jetoj te prindërit e mijë në fshatin dhe se nuk mendoj më të jetoj me te, kurse E..... fare nuk është interesuar për vajzën tonë. vijon dëshminë e saj dëshmitarja shpesh më ka ndarë edhe nga ushqimi, ushtronte dhunë ndaj meje duke më kapur për fyti dhe mosmarrëveshjet e shpeshta tonat kanë qenë si shkak i kushteve të vështira ekonomike dhe unë rastin e kam paraqitur në polici dhe kështu me datën 14.04.2019 unë nga ana e jam përzënë definitivisht nga shtëpia, kurse unë kujdesem për vajzën time.

I bashkangjitem ndjekjes penale dhe paraqes kërkesë pasurore-juridike, por lartësinë e kërkesës në shumë të mejteve monetare nuk mund ta përcaktoj, përfundon dëshminë e saj dëshmitarja e dëmtuara.

Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlihur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe ka konstatuar :

- se me datën 01.05.2018 rreth orës 08:20 në Rrugënnë Shtime, me dashje ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarës-ish bashkëshortes së tij A.Sh, në atë mënyrë që pas një fjalosj verbale e sulmon fizikisht dhe e kap për fyti të dëmtuarën.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara dhe analizuara në shqyrtimin gjyqësor konform nenit 8 par.2 të KPPRK-së dhe atë: nga dëshmia dëshmitarës së dëmtuarës A.Sh dhe pjesërisht nga vet pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit, të gjitha këto janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Duke vërtetuar gjendjen faktike gjykata konfirmon se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qensore të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, andaj, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe në kuptim të dispozitave ligjore të cituara në dispozitiv të aktgjykimit i shqiptoj denim me kusht konform nenit 51 dhe 52 par.2 të KPRK-së, pra denimin me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili denim nuk do të ekzekutohet me periudhë verifikimi prej 1 (një) viti nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale . Gjykata denimin konform nenit 75 e 76 të KPPRK-së të akuzuarit ia ka zbutur denimin nën minimum të paraparë ligjor, nga se pasoja e veprës penale ka qenë e vogël, por edhe i dëmtuari-prindi i tij ka pasur sjellje agresive ndaj të pandehurit.

Gjykata tezën mbrojtëse të propozuar nga i pandehuri, se kinëse nuk e ka sulmuar të dëmtuarën A. Sh, por është⁷ e vërtetë se e kam sukmuar verbalisht ditën kritike nuk e ka pranuar si të bazuar nga pohimet e tij ishin të pa baza, sepse ka qenë një përpjekje për të iu shmangur përgjegjësisë penale. Por, tezën mbrojtëse se të dëmtuarën nuk e ka sulmuar me kapje për fyti nuk e ka aprovuar dhe mbi këtë të akuzuarin e ka shpallur fajtor në bazë të paragrafit 1 të nenit 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarës A.Sh, ku dëshmitarës – së dëmtuarës ia fali pjesërisht besimin nga se dëshmia e saj ishin bindëse sa i përket përdorimit të forcës nga ana e të akuzuarit, por nuk ishte buindëse sa i përket mjetit të rrezikshëm apo të fortë për kryerjen e kësaj vepre penale.

-
- Përdorim i i forcës konsiderohet edhe shtyerja e të dëmtuarit, kapja për gjoksi.
 - Vepra penale sumit ekziston me kusht që viktimës e cila qëllohet të mos i shkaktohet lëndime trupore
 - Shtërngimi merret me qëllim që personin tjetër ta detyroj të ndërmerr apo të mos ndërmerr një veprim në kundërshtim me vullnetin e tij-Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës-*Faqe 503*.

Gjatë shqiptimit të dënimit në kuptim të nenit 73 dhe 75 e 76 të KPRK-së gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysh faktin se është i pa punë e i martuar me fëmijë e pa kurrëfar të ardhurash, pra është i gjendjes shumë të varfër, kurse si rrethana rënduese pati parasysh peshën e veprës penale dhe pasojat e saja, andaj, gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar te i akuzuari do të ndikoj pozitivisht që në të ardhmen mos të kryej asnjë vepër tjetër penale, me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i parapar me ligj nga neni 41 i KPRK-së.

Ndërkaq, denimi me burg i kushtëzuar nga neni 51 i KPRK-së i shqiptuar në kohëzgjatje prej 4 muajve nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.

Konform nenit 463 par.1 dhe par.2 të KPPRK-së, e dëmtuara A.S.Sh nga fshati në emër të kërkesë pasuror-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së i akuzuari obligohet në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqsor të paguaj kësaj gjykate shumënprej 30 /tridhjetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së katgjykimit nën kërcnimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 30 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
P.nr. 849/18 të dt.01. 07.2019.

Sekretarja juridike
Igballe Arifi

Gj y q t a r i,
Elmaz Zenuni

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.

Një kopje e aktgjykimit ti dërgohet të dëmtuarës/ A.S.Sh nga fshati